




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN



## VENDIM

Nr.1, datë 04.07.2022

## PËR

**KORRIGJIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES  
NR.224/1 PROT., DATË 21.03.2017 MIRATUAR ME VENDIMIN  
NR.13, DATË 16.02.2017 “PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR  
NËNTOKËSOR PËR UJË Të AMBALAZHUAR (IMBOTILIM)”,  
SUBJEKTIT “ARDJAN PATOZI”**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

## V E N D O S I:

1. Korrigjimin e koordinatave të lejes nr.224/1 prot., datë 21.03.2017 miratuar me vendimin nr.13, datë 16.02.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Shkumbin si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit (KRGJSH)

Pusi-1

Nga: X= 470708; Y= 4546605; Z= 11 m.m.n.d

Në : X= 470683; Y= 4546629; Z= 10 m.m.n.d

Sasia e ujit që jepet në përdorim:  $Q=0.003 \text{ m}^3/\text{s}$

2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes nr.224/1 prot., datë 21.03.2017 miratuar me vendimin nr.13, datë 16.02.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Shkumbin për “Përdorim burimi ujqor nëntokësor për ujë të ambalazhuar (imbotilim)” me koordinatat e korigjuara sipas pikës 1 të këtij projekt vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SHKUMBIN**

**MAJLINDA PERRIU**

